

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E SHTIMES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **617-26-4772-1-1-1 / 617-2026-028-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me dru për institucionet e Komunës së Shtimes – Kontratë Kornizë 24 muaj**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Evergreen Timber SH.P.K. - 812051770**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rruga Zllashi I Vogël, pn**

(Adresa)

**Prishtinë**

(Vendi)

**10000**

(Kodi postar)

**+38344737579**

(Numri Telefonit)

**N/A**

(Numri i Faks-it)

**Blerim Vitija**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**[info.evergreentimber@gmail.com](mailto:info.evergreentimber@gmail.com)**

(Adresa elektronike)



**16.07.2026**

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Autoriteti Kontraktues, **Komuna e Shtimes**, ka publikuar më 17.06.2026 Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit për aktivitetin e prokurimit me numër **617-26-4772-1-1-1**, numër të brendshëm 617-2026-028-1-1-1, me titull **“Furnizim me dru për institucionet e Komunës së Shtimes – Kontratë Kornizë 24 muaj”**.

Afati fillestar për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve ishte caktuar më 08.07.2026, ora 14:00. Kriteri për dhënien e kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Më 02.07.2026, Operatori Ekonomik Evergreen Timber SH.P.K. ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke paraqitur gjashtë pretendime të ndara dhe të argumentuara lidhur me kriteret ekonomike, financiare dhe teknike të Dosjes së Tenderit.

Më 06.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë Vendim mbi Kërkesën për Rishqyrtim, me të cilin kërkesa është aprovuar pjesërisht. AK ka larguar kërkesën për mjete të gatshme ose kredi të pakushtëzuar në vlerë prej 100,000.00 euro dhe ka ndryshuar mënyrën e dëshmimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Për pretendimet e tjera, AK është kufizuar në formulimin se kërkesa “në pjesën tjetër refuzohet”, pa i identifikuar dhe pa i shqyrtuar veçmas ato.

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Po. Operatori Ekonomik ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më 02.07.2026. Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim më 06.07.2026, me të cilin kërkesa është aprovuar pjesërisht dhe në pjesën tjetër është refuzuar. Kopja e kërkesës dhe kopja e vendimit i bashkëngjiten kësaj ankese.

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. **Neni 1 i LPP-së** – sepse kriteret e mbetura krijojnë shpenzime dhe rreziqe të panevojshme, ndikojnë në koston e ofertës dhe cenojnë përdorimin efikas dhe ekonomik të fondeve publike.
2. **Neni 7 i LPP-së** – sepse kërkesa për sigurimin paraprak të 60% të sasisë së druve dhe kërkesa për mjete transportuese me karakteristika shumë specifike kufizojnë konkurrencën dhe i vendosin operatorët ekonomikë në pozitë të pabarabartë.
3. **Neni 27 i LPP-së** – sepse Dosja e Tenderit përmban kërkesa që nuk janë arsyetuar si objektivisht të domosdoshme dhe proporcionale me natyrën e kontratës kornizë 24-mujore.

4. **Neni 68 i LPP-së** – në lidhje me kriteret ekonomike dhe financiare, për atë që vendimi i AK-së nuk paraqet formulimin e plotë dhe përfundimtar të kriterit të ndryshuar.
5. **Neni 69 i LPP-së** – sepse kriteret për 60% të sasisë së druve dhe për dy kamionë me vëç, me dy dër, 26 dhe 28 ton, nuk janë arsyetuar si kapacitete minimale të domosdoshme.
6. **Neni 108/A i LPP-së** – sepse AK nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar vëçmas pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, por ka refuzuar në mënyrë të përgjithshme “pjesën tjetër”.
7. **Neni 17 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik** – sepse kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të lidhura me objektin, të nevojshme dhe proporcionale, pa kufizuar konkurrencën më shumë sesa është e domosdoshme.
8. **Neni 25 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik** – sepse dëshmitë dhe dokumentet e kërkuara duhet të kufizohen në ato që nevojiten realisht për verifikimin e kapaciteteve dhe nuk duhet të krijojnë barriera të panevojshme.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtrore.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

## I. Hyrje dhe objekti i ankesës

Kjo ankesë nuk konteston pjesën e Vendimit të AK-së me të cilën është larguar kriteri për mjete të gatshme ose kredi të pakushtëzuar në vlerë prej 100,000.00 euro. Po ashtu, ankuesi evidenton se AK ka ndryshuar mënyrën e dëshmimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar duke i paraqitur dokumentet si alternativa.

Ankesa drejtohet kundër pjesës së Vendimit me të cilën pretendimet e tjera janë refuzuar pa identifikim, pa shqyrtim individual dhe pa arsyetim faktik, teknik dhe juridik. Fokusi kryesor është te kërkesa për dëshmi nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës për 60% të sasisë së parashikuar dhe te kërkesa për dy kamionë me vinç, me dy dyer, me peshë minimale 28 dhe 26 ton.

### PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1

#### Mosshqyrtimi veçmas i secilit pretendim dhe refuzimi i paarsyetuar i “pjesës tjetër”

Në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 02.07.2026, ankuesi ka paraqitur gjashtë pretendime të dallueshme, secilin me titull, citim të kriterit, argumentim faktik e juridik dhe kërkesë konkrete. Pretendimet kanë të bëjnë me: raportet e auditimit; mjetet financiare prej 100,000.00 euro; dëshminë për 60% të sasisë së druve; kamionët 26 dhe 28 ton; efektin kumulativ të kriterëve; dhe mungesën e arsytimit objektiv.

Autoriteti Kontraktues ka trajtuar konkretisht vetëm kriterin prej 100,000.00 euro dhe mënyrën e dëshmimit të kapacitetit ekonomik e financiar. Për pretendimet e tjera, vendimi nuk përmban ndarje sipas numrit të pretendimit, nuk citon argumentet e ankuesit dhe nuk jep përgjigje individuale.

***“Prandaj, kërkesa për rishqyrtim aprovohet pjesërisht, ndërsa në pjesën tjetër refuzohet.”***

Formulimi “në pjesën tjetër refuzohet” nuk tregon se cili pretendim është refuzuar, cilat fakte nuk janë pranuar, pse nuk janë pranuar dhe mbi çfarë analize AK ka konstatuar se kriteret e mbetura janë të nevojshme dhe proporcionale.

Në veçanti, vendimi nuk përmban asnjë përgjigje për përqindjen 60%, për procedurën dhe koston e marrjes së vërtetimit nga APK, për kërkesën që lideri i grupit ta ketë 60% të sasisë, për tonazhin 26 dhe 28 ton, për formulimin “me dy dyer” dhe për domosdoshmërinë që të dy kamionët të kenë vinç.

Për pasojë, AK nuk e ka përmbushur detyrimin për shqyrtim real të kërkesës për rishqyrtim. Një vendim formal pa trajtim individual të pretendimeve nuk i mundëson ankuesit të kuptojë arsyet e refuzimit dhe nuk i mundëson OSHP-së kontroll të plotë mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes.

### PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2

#### Kërkesa joproportionale për dëshmi nga APK për 60% të sasisë së parashikuar

Kriteri i kontestuar në Dosjen e Tenderit është cituar si vijon:

***“OE duhet të ofrojë dëshmi mbi prejardhjen e druve nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, për 60% të sasisë së parashikuar.”***

***“Dëshmi mbi prejardhjen e druve nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, e nënshkruar dhe e vulosur. Në rast konsorciumit Lideri i GOE duhet të ketë 60% të sasisë.”***

#### 2.1. Kriteri nuk kërkon vetëm aftësi për furnizim, por sigurim paraprak të mallit

Për të marrë vërtetim për një sasi konkrete prej 60% të lëndës drusore, OE duhet ta ketë siguruar paraprakisht atë sasi. Në gjendjen reale të tregtimit dhe furnizimit me dru, kjo nënkupton blerjen e druve para përfundimit të tenderit, transportimin e tyre nga mali ose

burimi i furnizimit deri në depo, shkarkimin, sistemimin, ruajtjen dhe paraqitjen për verifikim.

Kriteri nuk kufizohet në dëshmimin e një burimi të ligjshëm të furnizimit ose në aftësinë e OE-së për ta siguruar mallin pas nënshkrimit të kontratës. Ai e ngarkon OE-në me realizimin paraprak të një pjese të konsiderueshme të furnizimit, para se të dihet fituesi.

## **2.2. Transporti i detyrueshëm përmes depos krijon shpenzime shtesë dhe rrit çmimin**

Në realizimin normal të furnizimit, drutë mund të transportohen drejtpërdrejt nga mali ose nga burimi i ligjshëm i furnizimit me Fletëpercejllje që lëshohet nga pylltari dhe vertetin që drutë kan prejardhje legjitime. Për gjdo sasi të faturuar AK mund të kërkojë që OE ta dëshmojë me dokumente përkatëse që mund të jenë fletëpercejlljet të lëshuara nga pylltarët e rajoneve të ndryshme ose vendimet mbi prerje, që vërtetojnë se drutë e furnizuara janë prerë në formë ligjore dhe ju vërtetohet prejardhja e tyre. Rrjedha normale është: burimi i furnizimit → destinacioni i AK-së.

Për shkak të kriterit për vërtetim paraprak të 60% të sasisë, OE detyrohet të ndjekë një rrjedhë më të kushtueshme: burimi i furnizimit → depoja e OE-së → destinacioni i AK-së. Kjo shkakton ngarkim shtesë, transport nga mali në depo, shkarkim dhe zhvendosje në depo, kosto të magazinimit, ringarkim dhe transport të dytë deri në institucion. Këto janë shpenzime reale që nuk do të ekzistonin në rastin e furnizimit të drejtpërdrejtë. Shpenzimet e panevojshme rrisin koston e blerjes dhe furnizimit. OE-të janë të detyruara t'i përfshijnë këto kosto në çmimin e ofertës, çka mund të rezultojë në çmim më të lartë për AK-në dhe përdorim më pak ekonomik të fondeve publike.

## **2.3. Investim i konsiderueshëm para se të dihet rezultati i tenderit**

OE detyrohet të investojë mjete të konsiderueshme për blerjen e 60% të sasisë së parashikuar pa e ditur nëse do të shpallet fitues, nëse oferta e tij do të jetë me çmimin më të ulët, nëse procedura do të vazhdojë pa ankesa dhe kur do të fillojnë porositë.

Nëse ankuesi nuk e fiton kontratën, sasia e blerë mbetet në stok. Nuk ekziston garanci se ajo sasi do të shitet te një blerës tjetër, brenda një kohe të arsyeshme dhe me çmim që mbulon investimin dhe shpenzimet e krijuara.

Kjo e ekspozon OE-në ndaj humbjes së investimit, bllokimit të kapitalit dhe shpenzimeve të vazhdueshme të ruajtjes. Vlera e 60% të sasisë së një kontrate 24-mujore nuk është vlerë e vogël dhe nuk mund të trajtohet si shpenzim i zakonshëm i përgatitjes së ofertës.

## **2.4. Rreziku i dëmtimit, kalbjes dhe humbjes së vlerës së druve**

Druri i ruajtur për kohë të gjatë mund të dëmtohet nga lagështia, kushtet atmosferike, kalbja, insektet ose krimbat dhe mund të humbë cilësinë dhe vlerën tregtare.

Prandaj, OE nuk rrezikon vetëm kapitalin e bllokuar. Ai rrezikon edhe dëmtimin fizik të mallit dhe humbjen e një pjese ose të tërë vlerës së investimit, pa pasur kontratë dhe pa pasur garanci se malli do të pranohet nga AK-ja.

## **2.5. Përqindja 60% nuk është arsyetuar nga AK-ja**

AK nuk ka paraqitur në vendim asnjë analizë që shpjegon pse kërkohet pikërisht 60% dhe jo një përqindje tjetër. Nuk është treguar lidhja ndërmjet 60% të sasisë dhe dinamikës së furnizimit, afateve të porosive ose kapacitetit të institucioneve për pranimin e druve.

Kontrata është kontratë kornizë 24-mujore. Nga dokumentet që janë objekt i kësaj ankese nuk rezulton se 60% e sasisë do të porositet dhe dorëzohet menjëherë. Përkundrazi, natyra e një kontrate kornizë 24-mujore është e lidhur me furnizime sipas nevojave dhe porosive gjatë periudhës së kontratës dhe sezonave dimrore. Po ashtu AK nuk ka specifikuar a duhet të nxirret Vërtetimi nga APK për 60% të sasisë së parashikuar për 12 muaj apo për 24 muaj që i bie se drutë do të grumbullohen dhe të ruhen për 24 muaj me heret për 2 sezona dimrore.

AK nuk ka shpjeguar pse qëllimi i ligjshëm për të siguruar prejardhjen e druve nuk mund të arrihet me masa më pak kufizuese, si vërtetimi i prejardhjes për secilën sasi gjatë dorëzimit, marrëveshje me furnitorë, dëshmi për burime të ligjshme ose kontrata të furnizimit.

## **2.6. Kërkesa për liderin e GOE-së është e paarsyetuar**

Dosja e Tenderit kërkon që, në rast konsorciumi, lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomikë ta ketë 60% të sasisë. AK nuk ka shpjeguar pse kapaciteti i grupit nuk mund të vlerësohet në tërësi dhe pse pikërisht lideri duhet ta posedojë të gjithë këtë sasi.

Ky formulim e kufizon përdorimin e kapaciteteve të anëtarëve të grupit dhe e bën kriterin edhe më të rëndë, pa arsyetim të paraqitur në vendim.

## **2.7. Masat më pak kufizuese**

Qëllimi për sigurimin e prejardhjes së ligjshme të druve mund të arrihet pa krijimin paraprak të stokut, për shembull përmes:

- dëshmisë së prejardhjes për secilën sasi konkrete gjatë furnizimit;
- marrëveshjeve ose kontratave me furnitorë të ligjshëm;
- dokumenteve që provojnë burimet e furnizimit;
- deklarimeve dhe obligimeve kontraktuale të OE-së për dorëzimin e druve me prejardhje të ligjshme;
- kontrollit dhe refuzimit të çdo sasi që nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës gjatë ekzekutimit.

Këto masa e mbrojnë interesin e AK-së pa e detyruar çdo tenderues të blejë, transportojë dhe ruajë paraprakisht 60% të sasisë.

## **PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3**

### **Kriteri kufizues dhe i paqartë për dy kamionë me vinç, me dy dyer, 26 dhe 28 ton**

Kërkesa 5. Kontraktori i furnizimeve duhet të ofroj dëshmi se posedon makinerinë dhe mjetet e punës të domesdoshme për furnizimin me dru të paktën dy (2) kamionë me vinça me dy dyer i përshtatshëm për transportin e lendes drusore njëri nga kamionët duhet të ketë peshë minimumi 28 ton dhe një kamionë minimumi 26 tonë.

### **3.1. Formulimi “me dy dyer” është i paqartë**

AK nuk ka sqaruar se për cilat dyer bëhet fjalë, çfarë funksioni teknik kanë ato dhe pse një kamion me konfigurim tjetër ose me më shumë dyer nuk do të ishte i përshtatshëm.

Sipas kuptimit literal, një kamion me më shumë se dy dyer mund të vlerësohet se nuk e plotëson kriterin, edhe nëse është plotësisht i aftë për transport dhe shkarkim. Kriteri krijon hapësirë për interpretim arbitrar dhe eliminim mbi karakteristikë që nuk është lidhur me rezultatin e kontratës.

### **3.2. Peshat 26 dhe 28 ton nuk janë arsyetuar**

Vendimi i AK-së nuk shpjegon pse duhen pikërisht dy kamionë të kategorisë së rëndë, njëri 28 ton dhe tjetri 26 ton. Nuk është paraqitur analizë e sasive për transport, frekuencës së dërgesave, kushteve të rrugëve ose qasjes në secilin institucion.

Nuk është shpjeguar pse furnizimi nuk mund të realizohet me kamionë me peshë më të vogël, përmes më shumë dërgesave ose përmes kombinimit të mjeteve sipas lokacionit.

### **3.3. Kufizimet praktike në qytet dhe te shkollat**

Kamionët 26 dhe 28 ton janë mjete të rënda. Shumica e shkollave dhe institucioneve që do të furnizohen ndodhen brenda qytetit ose vendbanimeve, ku mund të ketë rrugë të ngushta,

hyrje të kufizuara, oborre shkollore, kthesa të vogla, automjete të parkuara dhe hapësirë të kufizuar për manovrim.

Në këto lokacione, një kamion më i vogël mund të jetë praktikisht më i përshtatshëm, më i sigurt dhe më efikas. Madhësia më e madhe nuk është automatikisht dëshmi e përshtatshmërisë.

### **3.4. AK imponon mënyrën e organizimit të transportit**

Detyrimi i OE-së është të dorëzojë drutë në sasinë, cilësinë, afatin dhe lokacionin e kërkuar. Ky rezultat mund të arrihet me mjete dhe organizim të ndryshëm.

Kriteri i kontestuar nuk përcakton vetëm rezultatin, por imponon një mënyrë të vetme organizimi: dy kamionë, të dy me vinç, me dy dyer dhe me pesha të sakta minimale. AK nuk ka arsyetuar pse alternativat funksionalisht të barasvlershme nuk pranohen.

### **3.5. Domosdoshmëria e dy vinçave nuk është analizuar**

Ankuesi nuk mohon se vinçi mund të jetë i dobishëm për ngarkim ose shkarkim. Çështja është se AK nuk ka shpjeguar pse të dy kamionët duhet patjetër të kenë vinç, pse nuk mjafton një mjet me vinç ose një mënyrë tjetër e ligjshme e shkarkimit dhe nëse çdo lokacion kërkon përdorimin e vinçit.

Kombinimi kumulativ i kërkesave – dy kamionë, të dy me vinç, me dy dyer, njëri 26 ton dhe tjetri 28 ton – nuk është mbështetur me analizë teknike.

### **3.6. Formulimi proporcional i kriterit**

Kriteri duhet të lidhet me funksionin dhe rezultatin e kërkuar. Një formulim proporcional do të ishte:

*“Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka në dispozicion mjete transportuese dhe pajisje të mjaftueshme e të përshtatshme për transportimin dhe shkarkimin e druve në të gjitha lokacionet e kontratës, përmes pronësisë, qirasë ose marrëveshjeve të tjera të ligjshme.”*

Çdo kapacitet minimal shtesë duhet të mbështetet në analizë objektive të sasive, afateve dhe lokacioneve.

## **PRETENDIMI ANKIMOR NR. 4**

### **Efekti kumulativ i kriterëve të mbetura**

AK ka larguar kriterin prej 100,000.00 euro dhe ka lehtësuar mënyrën e dëshmimit të kapacitetit financiar. Megjithatë, nuk ka analizuar efektin e kombinuar të dy kriterëve të mbetura: sigurimin paraprak të 60% të sasisë dhe posedimin e mjeteve shumë specifike të transportit.

Një OE mund të ketë përvojë, burime të ligjshme furnizimi dhe mjete të mjaftueshme për realizimin e kontratës, por të përjashtohet vetëm sepse nuk ka blerë paraprakisht 60% të druve ose nuk posedon pikërisht kamionë me karakteristikat e kërkuara.

Kjo e ngushton konkurrencën te operatorët që tashmë kanë stok të madh dhe mjete shumë specifike, pa u provuar se vetëm ata mund ta realizojnë kontratën.

## **PRETENDIMI ANKIMOR NR. 5**

### **Paqartësia e formulimit të ri për kapacitetin ekonomik dhe financiar**

AK ka vendosur që kriteri ekonomik dhe financiar të dëshmohet me njërin nga dokumentet: vërtetim bankar, deklarata vjetore tatimore ose raport auditimi.

Megjithatë, vendimi nuk paraqet tekstin e plotë të kriterit të korrigjuar, nuk sqaron nëse mbetet pragu i qarkullimit prej 484,600.00 euro, cilën periudhë duhet të mbulojnë dokumentet dhe nëse raporti i auditimit duhet të jetë për dy nga tri vitet.



Kërkohet që çdo ndryshim të publikohet me formulim të plotë, të qartë dhe të njëjtë për të gjithë OE-të, në mënyrë që të mos ketë paqartësi gjatë ofertimit dhe vlerësimit.

## **KËRKESA DREJTUAR PANELIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në faktet, argumentet dhe provat e paraqitura, propozojmë që Paneli Shqyrtues i OSHP-së të nxjerrë këtë:

### **V E N D I M**

- I. APROVOHET**, si e bazuar, Ankesa e Operatorit Ekonomik Evergreen Timber SH.P.K.
- II. ANULOHET** pjesërisht Vendimi i Autoritetit Kontraktues Komuna e Shtimes i datës 06.07.2026, në pjesën me të cilën pretendimet e ankuesit janë refuzuar pa shqyrtim dhe pa arsyetim individual.
- III. KONSTATOHET** se Autoriteti Kontraktues nuk i ka shqyrtuar veçmas pretendimet lidhur me kërkesën për 60% të sasisë së druve, liderin e GOE-së, kamionët 26 dhe 28 ton, formulimin “me dy dyer”, efektin kumulativ dhe mungesën e arsytimit objektiv.
- IV. URDHËROHET** Autoriteti Kontraktues që ta largojë nga Dosja e Tenderit kërkesën për posedimin ose dëshmimin paraprak nga APK të 60% të sasisë së parashikuar të lëndës drusore.
- V. URDHËROHET** Autoriteti Kontraktues që prejardhjen e ligjshme të druve ta kërkojë për sasitë konkrete gjatë furnizimit ose përmes dëshmive të tjera proporcionale që provojnë burimin dhe aftësinë e furnizimit, pa kërkuar blerjen, transportimin dhe magazinimin paraprak të 60% të sasisë.
- VI. URDHËROHET** Autoriteti Kontraktues që ta largojë kërkesën për dy kamionë me peshë minimale 26 dhe 28 ton dhe ta largojë ose sqarojë formulimin kufizues “me dy dyer”.
- VII. URDHËROHET** Autoriteti Kontraktues që kriterin për mjetet e transportit ta riformulojë në mënyrë funksionale dhe proporcionale, duke kërkuar mjete të mjaftueshme e të përshtatshme për transportimin dhe shkarkimin e druve në lokacionet e kontratës, pa karakteristika të paarsyetuara.
- VIII. URDHËROHET** Autoriteti Kontraktues që ta publikojë formulimin e plotë dhe të qartë të kriterit të ndryshuar për kapacitetin ekonomik dhe financiar.
- IX. URDHËROHET** Autoriteti Kontraktues që, pas korrigjimit të Dosjes së Tenderit, ta zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 53.7 të LPP-së.
- X. DETYROHET** Autoriteti Kontraktues që t’i zbatojë në tërësi konstatimet dhe urdhrat e vendimit të OSHP-së.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmi material nuk mund të llogaritet ende në shumë të saktë, pasi aktiviteti ndodhet në fazën para-ofertuese.

Kriteri për 60% të sasisë e detyron ankuesin të blejë dhe transportojë paraprakisht një sasi të konsiderueshme të druve, të krijojë shpenzime të transportit, shkarkimit, magazinimit dhe ringarkimit, si dhe të ekspozohet ndaj rrezikut që drutë të mos shiten, të dëmtohen, të kalben, të krymben ose të humbin vlerën.

Kriteri për kamionët e detyron ankuesin të sigurojë mjete me karakteristika shumë

specifike ose të hyjë në marrëveshje qiraje të posaçme, edhe pse furnizimi mund të realizohet me mjete të tjera të përshtatshme.

Nëse kriteret mbeten në fuqi, ankuesi rrezikon të mos mund të dorëzojë ofertë të përgjegjshme, pavarësisht kapacitetit real për realizimin e kontratës, dhe humb mundësinë për të konkurruar për kontratën dhe përfitimin ekonomik që do të mund të rridhte prej saj.

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*